



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 nëntor 2013
Nr.ref.:RK493/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI84/13

Parashtrues

Gani Sopaj, Ahmet Sopaj dhe Nazmije Sopaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev. nr. 294/2010, të 10 prillit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Gani Sopaj, Ahmet Sopaj dhe Nazmije Sopaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesit), të përfaqësuar nga z. Sehad Haliti, avokat nga Suhareka.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 294/2010, të 10 prillit 2013, i cili u është dorëzuar parashtruesve më 5 maj 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 294/2010, pasi që pretendohet se me të u janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), gjegjësisht me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 13 qershor 2013, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 qershor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI-84/13, e caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtare raportuese. Në të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI-84/13, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 8 korrik 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.
8. Më 18 tetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 20 shtator 2000, një nga parashtruesit, z. Gani Sopa, paraqiti padi për vërtetimin e së drejtës së pronës në Gjykatën Komunale në Suharekë.

10. Më 10 korrik 2003, Gjykata Komunale në Suharekë (Aktgjykimi C. nr. 113/2000) e aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar. Për më tepër, ajo konstatoi se sipas kontratës për shitblerje, parashtruesi i kërkesës është pronar i ngastrës së kontestuar kadastrale dhe se e paditura, Komuna e Suharekës, është e detyruar t'ia njohë parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronës. Avokati publik i Komunës së Suharekës ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.
11. Më 9 dhjetor 2004, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Ac. nr. 355/2003) e refuzoi ankesën e avokatit publik si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë, të 10 korrikut 2003. Avokati publik i Komunës së Suharekës ushtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë dhe të Gjykatës së Qarkut në Prizren.
12. Më 25 janar 2006, Gjykata Supreme (Vendimi Rev. nr. 63/2005) e aprovoi revizionin si të bazuar. Gjykata Supreme i anuloi vendimet e gjykatave më të ulëta dhe e ktheu lëndën për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme konstatoi se *“[...] aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta përmbajnë shkelje thelbësore të Ligjit për procedurën kontestimore, gjegjësisht nenit 354 paragrafi 2 pika 14 në lidhje me nenin 375 paragrafi 1 të Ligjit për procedurën kontestimore dhe për shkak të këtyre mangësive, aktgjykimi nuk mund të shqyrtohet.”*
13. Më 15 qershor 2007, Gjykata Komunale në Suharekë (Aktgjykimi C. nr. 69/07) gjatë rigjyimit e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesve të kërkesës se ata janë pronarë të ngastrës kontestuese mbi bazën e trashëgimisë. Gjykata Komunale në Suharekë konstatoi se *“Parashtruesit nuk i kanë ofruar gjykatës prova reale në lidhje me padinë për fitimin e pronësisë. Prandaj, paluajtshmëria kontestuese është e regjistruar në emër të pasurisë shoqërore [...]”*. Për më tepër, Gjykata Komunale në Suharekë konstatoi se *“Sipas mendimit të gjykatës, fshatarët e fshatit Bukosh nuk e kanë pasur të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese dhe nuk kanë pasur të drejtë t'ia shesin paraardhësit të parashtruesve të kërkesës, nuk kanë pasur të drejtë ligjore për tjetërsimin e paluajtshmërisë kontestuese, pra të njëjtit nuk kanë qenë pronarë, sepse pronësia në një mënyrë ka qenë e evidentuar, por edhe tani evidentohet në emër të pronësisë shoqërore.”* Parashtruesit u ankuan kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.
14. Më 6 mars 2008, Gjykata e Qarkut në Prizren (Vendimi Ac. nr. 361/2007) e aprovoi ankesën e parashtruesve dhe e ktheu rastin për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e Qarkut në Prizren vlerësoi se *“Në vendosje të sërishme në këtë çështje juridike, gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësojë deklaratat e dëshmitarëve e në të njëjtën kohë të kërkojë nga eksperti i gjeodezisë në Suharekë, apo nga Agjencia për Kadastër dhe Gjeodezi në Prishtinë, të deklarojë lidhur me atë nëse parcela nga tapia e cila gjendet në shkresa të lëndës i përgjigjet parcelës kontestuese dhe të jepet sqarimi lidhur me këto fakte relevante ligjore [...]”*.
15. Më 3 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Suharekë (C. nr. 81/08) e aprovoi padinë e parashtruesve dhe konstatoi se parashtruesit janë pronarë të parcelës kontestuese në bazë të trashëgimisë. Gjykata Komunale në Suharekë konstatoi

se “Në bazë të provave në shkresat e lëndës, e sidomos të tapisë dhe dëshmitarëve, padia e parashtruesve është e bazuar.” Avokati publik i Komunës së Suharekës ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

16. Më 29 korrik 2010, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Ac. nr. 37/2010) e aprovoi ankesën e avokatit publik si të bazuar dhe e revokoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë, të 3 dhjetorit 2009. Gjykata e Qarkut vendosi se padia e parashtruesve duhet të refuzohet si e pabazuar, sepse nuk ka asnjë kontratë me shkrim për transferimin e pronës dhe nuk ka asnjë deklaratë të besueshme të ndonjë dëshmitari se shitësit e pronës ishin pronarë legjitimë të pronës. Për më tepër, Gjykata e Qarkut vlerësoi se “Ligji i tanishëm mbi marrëdhëniet e detyrimeve, po ashtu edhe Ligji i aplikuar në vitin 1970, kur blerja e pretenduar ka ndodhur, ka kërkuar kontratën në formë të shkruar mbi pronësinë e pasurisë së patundshme. Kontratat e tilla, të cilave u mungon forma me shkrim, janë të pavlefshme. Kjo është arsyeja pse Gjykata Supreme e Kosovës në procedurën e revizionit i ka udhëzuar instancat më të ulëta që të verifikojnë nëse kontrata ishte lidhur në mënyrën e duhur. Procedurat vijuese zbuluan mosekzistimin e kontratës me shkrim.” Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesit ushtroan revizion në Gjykatën Supreme.
17. Më 10 prill 2013, Gjykata Supreme e refuzoi revizionin e parashtruesve si të papranueshëm. Gjykata Supreme konstatoi se “Nga procesverbali mbi shqyrtimin kryesor të 11 prillit 2007, del se paditësit e kanë caktuar vlerën e kontestit në shumë prej 500 DM, gjegjësisht 250 euro, dhe kanë deklaruar se nëse gjykata mendon ndryshe, atëherë vlerën e kontestit mund ta përcaktojnë sipas detyrës zyrtare. Në shkresat e lëndës nuk ekziston vendimi i gjykatës për caktimin e vlerës së kontestit, ashtu që vlera e kontestit ka mbetur në shumë prej 250 eurosh. Me nenin 211.3 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), parashikohet që revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike, në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesa në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër nëse vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësve nuk e kalon shumën prej 3.000 eurosh. Duke pasur parasysh dispozitën e nenit 211.3 të LPK-së, që revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, nëse vlera e kontestit e treguar në padinë e paditësve nuk e kalon shumën prej 3.000 eurosh, ndërsa për faktin se vlerën e objektit të kontestit paditësit e kanë caktuar në procesverbal për shqyrtimin kryesor në shumë prej 250 eurosh, ndërsa padia është dorëzuar në gjykatë më 21 shtator 2000, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, revizioni i paditësve në këtë çështje juridike nuk është i lejuar dhe si i tillë duhet të hidhet poshtë.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesit pretendojnë se “Vendimet e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 294/2010, dhe Rev. nr. 63/2005, janë në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], sepse për të njëjtën çështje, i njëjti gjyqtar kryesues mori vendime të ndryshme dhe kjo është shkelje e së drejtës kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.”

19. Për më tepër, parashtruesit pretendojnë se “Kur të dy vendimet e shkallës së parë ishin në dobi të parashtruesve, Gjykata Supreme e pranoi revizionin e së paditurës (avokati publik i Komunës së Suharekës), dhe tani, kur vendimi i shkallës së dytë ishte në dobi të së paditurës, i njëjti gjyqtar kryesues i Gjykatës Supreme e hodhi poshtë revizionin, duke pohuar se vlera e ngastrës kontestuese nuk e tejkalon vlerën prej € 3,000.”

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesve, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës të Gjykatës, i cili parasheh se “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse (...) kërkesa është qartazi e bazuar.”
22. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Pra, kjo gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkritazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
23. Si përmbledhje, Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, e 10 korrikut 1991).
24. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit nuk e kanë mbështetur padinë në baza kushtetuese dhe nuk kanë ofruar prova se të drejtat dhe liritë e tyre themelore janë shkelur nga gjykatat e rregullta. Gjykata Supreme u ofroi parashtruesve një aktgjykim të arsyetuar mirë lidhur me atë se pse ishte refuzuar revizioni për herë të dytë. Gjykata gjithashtu vëren se kur ishte nxjerrë Vendimi i 25 janarit 2006 nga Gjykata Supreme, Ligji i aplikueshëm për procedurën kontestimore në nenin 382 parashihte se “Revizioni nuk lejohet në kontestet pasuroro-juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit ose me plotësim të një propozimi tjetër, në qoftë se vlera e objektit të kontestit të pjesës së kundërshtuar të aktgjykimit të formës së prerë nuk tejkalon 5,000 dinarë.” Sidoqoftë, në kohën kur ishte nxjerrë Vendimi i 10 prillit 2013 nga Gjykata Supreme, Ligji për procedurën kontestimore ishte ndryshuar dhe Ligji i aplikueshëm për procedurën kontestimore në nenin 211.3 parashihte se: “Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po qe se

vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 eurosh.”

25. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
26. Si përfundim, parashtruesit e kërkesës nuk kanë treguar pse dhe si u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Kësisoj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të rregullit 36 (1) c) dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, më 18 tetor 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani